VENDIM
Nr.937, datë 17.11.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.424, DATË 2.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 60 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Neni 9 i rregullores "Për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", që i bashkëlidhet vendimit nr.424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 9
Pagesa e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Akreditimit të paguhen, për çdo muaj, përkatësisht, me 30 për qind dhe 20 për qind të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm në ministri.".

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha